

Strategji Për Zhvillimin e Veprimtarisë Radiodifuzive

U miratua Strategjia Rregullatore për Zhvillimin e Veprimtarisë Audio dhe Audiovizuele për periudhën nga 2019 deri në 2023

Shkup, 14 mars 2019 – Agjencia në seancën e sotme e miratoi Strategjinë Rregullative për Zhvillimin e Veprimtarisë Audio dhe Audiovizuele për periudhën nga 2019 deri në 2023.

Agjencia e ka përpunuar këtë Strategji për të përcaktuar drejtimit e veprimit të saj në periudhën nga 2019 deri në 2023, në mënyrë që të përmirësojë shumë aspekte të medias në këtë periudhë pesë-vjeçare.

Me realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në Strategji, ndër të tjera, pritet të përmirësohet funksionimi i sistemeve të vetë-rregullimit dhe korigjimit, pluralizmit të pronësisë së medias dhe transparencës së tij të plotë, mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në përmbajtjen e mediave, duke siguruar një kornizë rregullatore që mundëson zhvillimin e mediave dhe zhvillimin e mëtejshëm të arsimit mediatik në media.

Takimi i mbajtur për versionin e dytë të punës së Strategjisë Rregullatore për Zhvillimin e Veprimtarisë Audio dhe Audiovizuele për periudhën nga 2019 deri në 2023

Shkup, 21 shkurt 2019. – Sot në Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele u mbajtë konsultimi final në lidhje me Strategjinë Rregullatore për Zhvillimin e Veprimtarisë Audio dhe Audiovizuele për periudhën nga 2019 deri në 2023.

Të pranishmit në takim diskutuan për versionin e dytë të Strategjisë, të cilin Agjencia ka zhvilluar për të përcaktuar drejtimet e veprimit të saj në periudhën nga 2019 deri në 2023, në mënyrë që të përmirësojë shumë aspekte të mediave.

Lajmërim për takim në lidhje me tekstin e punës për Strategjisë për zhvillimin e veprimtarisë audio dhe audiovizuele nga viti 2019 deri në 2023 – 25.12.2018

Shkup, 24.12.2018. – Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele më datë **25 dhjetor 2018 (e martë)**, në ora **12:00**, organizon takim në të cilin do të shqyrtohet teksti i punës së Strategjisë për trupin rregullues për zhvillimin e veprimtarisë audio dhe audiovizuele për periudhën nga viti 2019 deri më 2023 Takimi do të realizohet në hapësirat e Agjencisë, salla e konferencave – kati i dytë.

Agjencia i fton të gjithë të interesuarit që me mendimet dhe propozimet e tyre në lidhje me versionin e punës së Strategjisë, të dorëzojnë në contact@avmu.mk, më së voni deri më 25.01.2019.

Strategji Për Zhvillimin E Veprimtarisë Radiodifuzive 2008-2022



Shkup, 15.05.2017. – Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale sot shënoi edhe fillimin zyrtar të përgatitjes së Strategjisë për zhvillimin e veprimtarisë audio dhe audiovizuale nga viti 2018 e deri më vitin

2022.

Qëllimi i Strategjisë është të shënohen gjendjet vijuese në të cilën gjendet veprimtaria audio dhe audiovizuale në mënyrë që të përcaktohen qëllime dhe drejtime për zhvillimin e këtyre veprimtarive në pesë vitet e ardhshme, si dhe aktivitete konkrete për realizimin e këtyre qëllimeve. Strategjia është paraparë në Programin e punës së Agjencisë për vitin 2017 dhe e njëjta është që të planifikohet rezultati për procesin e gjerë konsultues me të gjithë faktorët nga veprimtaria me qëllim që e njëjta të përfshihet edhe në mënyrë adekuate të adresohen të gjitha çështjet kyçe të palëve të interesuara nga sfera mediatike.

Në strategji do të përcaktohen edhe aktivitete të caktuara me të cilat Agjencia do të pozicionojë qartë rolin e vetë si rregullator në nxitjen e zhvillimit të veprimtarisë, kurse propozimet dhe aktivitetet adekuate përmes së cilëve do të realizohen disa aspekte në sferën e medimeve, do të jepen nga faktorët kryesor të industrisë dhe subjektet që i nënshtrohen rregullimit.

Kontribut për Strategjinë nga aspekt i përvojave dhe rezultateve të punës, Agjencia pret edhe nga institucionet, përmes kompetencave të vera, si dhe organizatave civile, përmes projekteve të shumta të medimeve ku Agjencia ka dhënë përkrahjen e vet të plotë.

Agjencia konsideron se Strategjia për zhvillimin e veprimtarisë audio dhe audiovizuele 2018-2022 duhet të orientohen ndaj gjashtë fushave të prezantuara në këtë link, kurse propozimet lidhur me Strategjinë mund të dorëzohen deri në fund të muajit maj 2017 në këtë adresë elektronike strategjia2022@avmu.mk

Propozim-Strategjia për zhvillimin e veprimtarisë radiodifuzive në R.M. (2013-2017) me planin aksionar

Strategjia për zhvillimin e veprimtarisë radiodifuzive në R.M. (2007-2012)